



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 1266 / prot. 11

Ballsh më 19.03.2025

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e **Mërkurë, datë 26.03.2025, ora 14:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 25.02.2025.
3. **Projektvendim Nr.09:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.07:** Për miratimin e dokumentit “ Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit”, në territorin e Bashkisë Mallakastër.
5. **Projektvendim Nr.10:** Për miratimin e akordimit të vlerës financiare për mbulimin e shpenzimeve të funeralit të të ndjerëve Sabri Velaj dhe Novrus Velaj, fshati Çorrush, Njësia Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër.
6. **Projektvendim Nr.11:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z. Qazim Alushi, banorë i fshatit Metoh, Njësia Administrative Aranitas, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 15.03.2025
7. **Projektvendim Nr.12:** Për miratimin e tavaneve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

